



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

I DETYRUAR

VARIANTI **A**

E mërkurë, 1 qershor 2011

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe
 Gjimnazi: Drejtimi shoqëror dhe i përgjithshëm

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në dramë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9a	9b	10	11
Pikët												
Kërkesa	12a	12b	13	14	15	16	17	18	19	20	21a	21b
Pikët												
Kërkesa	22a	22b	23	24a	24b	24c	25a	25b	25c	25d		
Pikët												

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I**Martin Camaj****NJI VJET**

Shkove në pranverë
 kur kumbullat lulojnë mbi kodër
 e shelgjet gjethen në lumë.
 Mani n'oborr asht pjekë si tjetra herë
 e prroni nën shpi asht tha,
 xhingalla mbi plep ka britë e ka britë
 e ti s'e ke ndie, as pa.

Vjeshta kur erdh
 e strehët e pullazit lëshuen
 ujin n'oborr, në kusi,
 unë ndenja të dera tue mendue për ty.

Kur era nga bjeshka ia behi
 e prroni nën shpi u ngri
 dorën që në zjarrm isha tue nxe
 e prapova tue mendue për ty
 të ngrime nën dhe.

Për pyetjet nga 1 deri në 6 rrethoni vetëm alternativën e saktë.

1. Kjo poezi është një lirikë: **1 pikë**
 - A) intime
 - B) filozofike
 - C) e natyrës
 - D) shoqërore

2. Cila nga alternativat e mëposhtme shpreh më mirë atë ç'ka dashur të përcjellë autori? **1 pikë**
 - A) Natyra nxit te njerëzit dëshirën për të qenë pjesë e saj.
 - B) Dukuri të natyrës na kujtojnë ngjarje të ndryshme.
 - C) Çdo stinë e ngacmon heroin lirik duke i sjellë kujtime të trishta.
 - D) Pavarësisht dhimbjes, çdo ditë që kalon na bën ta harrojmë të shkuarën.

3. Nga kjo poezi duket qartë se heroi lirik: **1 pikë**
 - A) është tepër i dhënë pas natyrës.
 - B) s'e ka më pranë njeriun e dashur.
 - C) nuk ndihet mirë në stinën e dimrit.
 - D) bën fajtor natyrën për tragjedinë e tij.

4. Ndjesia që përjeton heroi lirik është: **1 pikë**
 - A) trishtim i thellë deri në vuajtje.
 - B) nervoizëm dhe ankth.
 - C) depression deri në marrëzi.
 - D) shqetësim i përzier me frikë.

5. Cili nga çiftet e mëposhtme krijon antonimi kontekstuale? **1 pikë**
- A) s'e ke ndie – as pa
 B) u ngri - t'ue nxe
 C) erdh – ia behi
 D) lulojnë - gjethen
6. Kjo poezi është shkruar në: **1 pikë**
- A) varg të lirë
 B) varg të thyer
 C) varg të bardhë
 D) varg të rimuar.
7. Autori e shtrin ndjesinë e tij shpirtërore në të katër stinët e vitit. Shpjegoni pse e bën ai këtë. **2 pikë**
- _____
- _____
8. Cili është mjedisi që shërben si sfond i kësaj poezie? Gjeni dy detaje tipike të tij. **3 pikë**
- a) mjedisi: _____
- b) detaji: _____ c) detaji: _____
9. Lexoni vargun e parë të poezisë. Nisur nga konteksti, cili është sinonimi i foljes *shkove*? Tregoni pse autori ka përzgjedhur këtë fjalë.
- a) Sinonimi: _____ **1 pikë**
- b) Arsyeja e përzgjedhjes: **1 pikë**
- _____
10. Gjeni dy vargje ku ndihet dhimbja dhe vetmia e heroit lirik. **2 pikë**
- a) _____ b) _____
11. Në strofën e fundit heroi lirik prapson dorën nga zjarri. Çfarë *ndjesie* mund të jetë duke provuar ai dhe pse? Argumentoni përgjigjen tuaj. **2 pikë**
- _____
- _____
- _____
12. Gjeni në poezi dy folje të formuara nga emrat. Cila është mënyra e tyre e fjalëformimit?
- a) _____ **2 pikë**
- b) _____ **1 pikë**
13. Kjo është një poezi ndërtuar mbi kontraste. Zbuloni dy prej tyre. **2 pikë**
- a) _____
- b) _____

PJESA II**GËTE****FAUSTI**

Margarita është në burg, për shkak të vrasjeve që ka kryer. Fausti shkon për ta nxjerrë nga qelia.

FAUSTI

Po më pushton një tmerr që e pata harruar
gjith' breng' e njerëzimit më pushton.
Në këtë kthinë të errët me lagështi
lëngon ajo.
Dhe faj' i saj s'qe veçse një ëndërr e bukur!
Ti druan të hysh tek ajo!
Ke frikë të shohësh përsëri!
Kjo drithma jote s'e shpëton nga vdekja!

(Kap kyçin. Dëgjohet një këngë nga brenda)

FAUSTI

Jam unë!
.....

MARGARITA *(Kthyer drejt tij)*

Je ti, pra! Ti me të vërtetë?

FAUSTI

Po, unë! Eja me mua!

MARGARITA

M'i zgjidhe prangat,
më rroke përsëri në qafë.
Po si nuk të vjen frikë ty prej meje?
A nuk e di, o shpirt, kë liron?

FAUSTI

Eja! Eja! Po thyhet nata. Eja!

MARGARITA

Të gjorën nënë e vrava
dhe foshnjën time e mbyta në ujë.
A nuk t'u dha dhuratë ty dhe mua?
Po, edhe ty. Ti je? Mezi besoj.
Pa jepma dorën! S'qenkam në ëndërr, jo!
E dashur dorë! Ah, pse e ke të lagur?!
Fshije!
Më ngjan e ke me gjak të lyster.
O perëndi! Ç'ke bërë ashtu?
Ngule shpatën në mill,
Të lutem!

FAUSTI

Ç'u bë, u bë! Harro të shkuarën!
Ti po më vret.

MARGARITA

Jo, duhet të jetosh akoma ti!
Do të përshkruaj varret një nga një
dhe të kujdesesh ti për to
që nesër.
Nënë ta vësh në vendin më të mirë
dhe fare pranë nënës tim vëlla;
mua disi veçan,
po jo dhe larg,
me vogëlushin tim në gji të djathtë.
Mos dergjet tjetër pranë meje!
Do të ish për mua fat i bardhë, i bukur
të dergjesha përkrah me ty!
Po tash për mua kjo mbaroi.
Më vjen sikur përpiqem të afrohem
dhe sikur ti më shtyn të më largosh,
po ti je prapë e po më këqyr me dhimbsuri.
.....

MARGARITA

Në qoftë atje përjashta varri
dhe po përgjon vdekja, shkojmë!
Shkoj drejt e në shtrat të çlodhjes s'amshuar;
Po asnjë çap më tutje.
Po shkon? Henrik, të vija dot me ty!

FAUSTI

Po, eja! Veç të duash! Dera është e hapur.

MARGARITA

Nuk mund; për mua s'ka më shpresë.
E përse t'iki?
Kudo të vete do t'më ndjekin.
Si mjer' kush arrin të bëhet lypës
dhe në çdo hap e çap e vret ndërgegjija!
Pastaj, si do të bëj, do të më zënë.

FAUSTI

Do rri me ty.

MARGARITA

Nxito! Nxito!
Shpëtoma foshnjëzën!
Shko udhës përpjetë,
anës përroit,
pastaj përmes vigut,
shko drejt në pyll,
në t'mëngjër,

ku është dërrasa,
te pellgu.
Nxito! Kape shpejt!
Përpiqet të ngrihet!
Ende përpëlitet!
Shpëtoje! Shpëtoje!

FAUSTI

E dashur! Zbardhi dita! Eja t' ikim!

MARGARITA

Ah, zbardhi dita! Dit' e fundit!
Duhej t' ish ditë e dasmës sime!
Se mos i thuash kujt se qe te Greta!
Kurora ime e shkretë, lamtumirë!
Si mori fund kjo puna jonë!

Do shihemi të dy sërish,
po jo në dasmën tonë.
Gjindja po grahin, po nuk bëjnë zë.
Sheshi dhe rrugët
nuk mund t' i nxënë;
kambana bie, stapi thyhet.
Si po më kapin, po më lidhin sytë!
Më shpien zvarrë te kërcuri i gjakut.
Pas trungut të gjakosur më shtrëngojnë.
Çdo qaf' e njerëzve ia ndien tehun
hanxharit që pret qafën time.
Bota po hesht si varri!

FAUSTI

Më mirë të mos kisha lindur.
.....

Për pyetjet nga 14 deri në 20 rrethoni vetëm alternativën e saktë.

14. Në cilën prej alternativave të mëposhtme është përdorur figura e metaforës? **1 pikë**

- A) Eja! Eja! Po thyhet nata. Eja!
- B) Më ngjan e ke me gjak të lyer.
- C) Se mos i thuash kujt se qe te Greta!
- D) Mos dergjet tjetër pranë meje!

15. Kur Margarita thotë: *Shkoj drejt e në shtrat të clodhjes s'amshuar* ajo nënkupton:

1 pikë

- A) kraharorin e të dashurit.
- B) shtëpinë e braktisur.
- C) shtratin e vdekjes.
- D) parajsën e shpirtit.

16. Margarita mendon se mund të ritakohet me Faustin:

1 pikë

- A) ditën e dasmës së tyre.
- B) vetëm në botën tjetër.
- C) në pyll, ku kanë dhe foshnjën e tyre të varrosur.
- D) pas disa vitesh, në kopshtin ku u panë për herë të parë.

17. Në cilën nga alternativat e mëposhtme është përdorur pasthirrma?

1 pikë

- A) Nuk mund; për mua s'ka më shpresë.
- B) Si mjer' kush arrin të bëhet lypës.
- C) Gjindja po grahin, po nuk bëjnë zë.
- D) Ah, zbardhi dita!

18. Cili është amaneti që Margarita i lë Faustit. **1 pikë**

- A) Ta ruajë të shenjtë kujtimin e saj.
- B) Të kujdeset për varret e njerëzve të saj të dashur.
- C) Të takohen edhe një herë para se ajo të vdesë.
- D) Të largohet përfundimisht nga Mefistofeli.

19. Brenga më e madhe e Margaritës lidhet me: **1 pikë**

- A) prishjen e ditës së dasmës.
- B) mënyrën si do të vdesë.
- C) rininë që i humbi kaq shpejt.
- D) fatkeqësinë që u shkaktoi njerëzve të saj të dashur.

20. Çfarë toni përdor Margarita në vargun: *Shpëtomë foshnjëzën!* **1 pikë**

- A) lutës
- B) ironizues
- C) dyshues
- D) ekzaltues

21.

- a) Ç'ndjenja provon Fausti para se të shkojë te Margarita? Pse ai ngurron ta takojë atë?

2 pikë

- b) Lexoni me kujdes vargjet e mëposhtme. Cilën skenë nga letërsia botërore ju kujtojnë ato?

1 pikë

*E dashur dorë! Ah, pse e ke të lagur?!
Fshije!
Më ngjan e ke me gjak të lyer.
O perëndi! Ç'ke bërë ashtu?*

22.

- a) Lexoni vargjet: *Nxito! Nxito!* deri te ... *Shpëtoje! Shpëtoje!* Përshkruani gjendjen mendore në të cilën ndodhet Margarita. Cila është fjala që mbart gjithë peshën e dramës së saj?

2 pikë

- b) Pse Margarita e ndien se duhet të “varroset” pak *mënjane*, por jo dhe *larg* nga varri i nënës dhe i vëllait?

2 pikë

23. Margarita do të dëshironte të jetonte. Tregoni dy arsye që e shtyjnë atë të heqë dorë nga kjo dëshirë. **2 pikë**

a) _____

b) _____

24.

a) Në fragmentin e dhënë, vini në dukje **një detaj** që tregon lidhjen e veprës “*Fausti*” me sfondin mesjetar. **1 pikë**

b) Lexoni me kujdes vargjet e mëposhtme. Ç’funktion luan përsëritja disa herë e fjalës “*dita*”, krahasuar me çastin në të cilin ndodhet Margarita? **1 pikë**

Ah, zbardhi dita! Dit’ e fundit!
Duhej t’ish ditë e dasmës sime!

c) Fausti thotë shumë pak fjalë kur dialogon me Margaritën. Duke e parë në raport me të, pse ai shprehet kaq shkurt dhe ç’tregon kjo për natyrën e tij? **2 pikë**

25. Nga antikiteti e deri në kohët moderne shkrimtarë të mëdhenj kanë përcjellë idenë se ***sjelljet dhe pasionet ekstreme shkaktojnë pasoja të pakthyeshme në jetën e njeriut***. Argumentoni vlerën e kësaj ideje në formën e një eseje. **8 pikë**

Shtjellimi i idesë (25a)	Organizimi dhe struktura (25b)	Stili dhe origjinaliteti (25c)	Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) (25d)	Totali
2 pikë	2 pikë	2 pikë	2 pikë	8 pikë